



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI I LËNDËS
Gjuhë e Huaj C-3

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore, 40 seminare
Viti / Semestri : Viti II, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – Gjuhë, letërsi dhe qytetërim turk
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore: Studenti duhet të ketë njohuri themelore në gjuhën turke. Lënda gjuhë turke si gjuhë e dytë zhvillohet në dy module të vendosura në semestrin e parë dhe semestrin e dytë. Studentët do të punojnë me metodën e nivelit të avancuar, në nivelin B1- B2 të metodës së përzgjedhur për mësim. Do dinë të përdorin aftësitë e të lexuarit kritik në gjuhën e huaj si leximi për të marrë kuptimin, për të nxjerrë konkluzione. Do përdorin strategji komunikimi.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Shkrimi i prezantimeve, organizim i mësimi në gjuhën turke.
- 2.Puna me fjalor të avancuar duke përdorur hamendësimin, nxjerrjen e kuptimit nga konteksti, njohjen e parashtesave dhe prapashtesave.
- 3.Zgjerimin e fjalorit duke përdorur përkufizimin, përdorimin e fjalëve në fjali.

Rezultatet e pritshme :

- 1.Të shkruajë dhe paraqesë prezantime të strukturuar në gjuhën turke, duke përdorur një gjuhë të qartë dhe të saktë në tema të ndryshme të nivelit të ndërmjetëm.
- 2.Të kuptojë dhe interpretojë tekste të përbëra në gjuhën turke, përmes strategjive të leximit kritik si analiza kontekstuale, nxjerrja e kuptimit dhe hamendësimi mbi fjalët e panjohura.
- 3.Të përdorë një fjalor të pasur dhe të saktë, duke identifikuar parashtesa, prapashtesa dhe përdorur përkufizime për të zgjeruar kompetencën leksikore në të shkruar dhe të folur.
- 4.Të zhvillojë ndërveprim të rrjedhshëm dhe koherent në gjuhën turke, duke përdorur strategji të avancuara komunikimi në kontekste të përditshme, akademike ose profesionale.